

**SUPREME COURT OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL**  
**KOLEGJI I APELIT TË AKP-së**  
**ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-224/11**

**Prishtinë**  
**2 gusht 2012**

Në çështjen juridike të:

**D. R.**

Kragujevac  
Srbija

***Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese***

vs

**1. J. Sh.**

Podujevë

**2. A. R. Sh.**

Podujevë

***Pala përgjegjëse në kërkesë/ Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, në lidhje me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/102/2011 (lëndët janë të regjistruara në AKP me numrat KPA24354, KPA24675, KPA24679, KPA24680, KPA24681, KPA24685, KPA24688, KPA24689, KPA24692, KPA24694, KPA24697, KPA24698, KPA24700 dhe KPA24701), i datës 23 shkurt 2011, pas shqyrtimit të mbajtur më 2 gusht 2012, mori këtë:

## AKTGJYKIM

- 1- Ankesa e paraqitur nga D. R. hidhet si e papranueshme.
- 2- Vendimi i Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/102/2011, i datës 23 shkurt 2011, për sa i përket lëndëve të regjistruara me numrat KPA24354, KPA24675, KPA24679, KPA24680, KPA24681, KPA24685, KPA24688, KPA24689, KPA24692, KPA24694, KPA24697, KPA24698, KPA24700 dhe KPA24701, anulohet *ex officio* dhe kërkesat hedhen poshtë pasi që nuk janë nën kompetencën e KKPK-së.
- 3- Shpenzimet e procedurës në shumën prej € 530 (pesëqind e tridhjetë) duhet të paguhet nga pala ankuese Buxhetit të Kosovës brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 21 shkurt 2007, D. R. si anëtare e familjes e poseduesit të së drejtës pronësore paraqiti katërmbëdhjetë kërkesa pranë Agjencionit Kosovar të Pronave (AKP), duke kërkuar ri-posedimin dhe kompensimin për përdorimin e paligjshëm të ngastrave të kërkuara. Ajo shpjegoi se i ati i saj i ndërë kishte qenë bashkë-pronar i parcelave të cilat kishin qenë uzurpuar nga një person i panjohur. Duke nënshkruar formularin e kërkesave, D. R. deklaroi se prona ishte humbur më 12 qershor 1999.

Të dhënat lidhur me ngastrat e kërkuara janë dhënë më poshtë:

| Numri i dosjes së lëndës       | Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar   |
|--------------------------------|--|
| GSK-KPA-A-224/11<br>(KPA24354) | Ngastra Nr. 2966, kullotë që ndodhet te vendi i quajtur “Suvi Do” në Dumnicë të Poshtme, Podujevë, me sipërfaqe prej 1 h 86 ar 41 m <sup>2</sup> ; |
| GSK-KPA-A-225/11<br>(KPA24675) | Ngastra Nr. 2958, kullotë që ndodhet te vendi i quajtur “Suvi Do” in Dumnicë e Poshtme Podujevë. me sipërfaqe prej 1 h 32 ar 20 m <sup>2</sup> ;   |
| GSK-KPA-A-226/11<br>(KPA24679) | Ngastra Nr. 3007, kullotë që ndodhet te vendi i quajtur “Suvi Do” in Dumnicë e Poshtme, Podujevë, me sipërfaqe prej 0 h 83 ar 26 m <sup>2</sup> ;  |

|                                |   |
|--------------------------------|---|
| GSK-KPA-A-227/11<br>(KPA24680) | Ngastra Nr. 2984, kullotë që ndodhet te vendi i quajtur “Suvi Do” in Dumnicë e Poshtme, Podujevë, me sipërfaqe prej 2 h 38 ar 95 m <sup>2</sup> ; (Possession List No. 382: 2 h 30 ar 10 m <sup>2</sup> );          |
| GSK-KPA-A-228/11<br>(KPA24681) | Ngastra Nr. 2962, fushë që ndodhet te vendi i quajtur “Suvi Do” in Dumnicë e Poshtme, Podujevë, me sipërfaqe prej 0 h 13 ar 14 m <sup>2</sup> ;   |
| GSK-KPA-A-229/11<br>(KPA24685) | Ngastra Nr. 2983, kullotë që ndodhet te vendi i quajtur “Suvi Do” in Dumnicë e Poshtme, Podujevë, me sipërfaqe prej 0 h 16 ar 00 m <sup>2</sup> ; (Possession List No. 382: 0 h 38 ar 00 m <sup>2</sup> );          |
| GSK-KPA-A-230/11<br>(KPA24688) | Ngastra Nr. 2982, kullotë që ndodhet te vendi i quajtur “Suvi Do” in Dumnicë e Poshtme, Podujevë, me sipërfaqe prej 2 h 13 ar 96 m <sup>2</sup> ; (Possession List No. 382: 1 h 40 ar 81 m <sup>2</sup> );          |
| GSK-KPA-A-231/11<br>(KPA24689) | Ngastra Nr. 2963, kullotë që ndodhet te vendi i quajtur “Suvi Do” in Dumnicë e Poshtme, Podujevë, me sipërfaqe prej 0 h 45 ar 58 m <sup>2</sup> ;   |
| GSK-KPA-A-232/11<br>(KPA24692) | Ngastra Nr. 2981, kullotë që ndodhet te vendi i quajtur “Suvi Do” in Dumnicë e Poshtme, Podujevë, me sipërfaqe prej 0 h 07 ar 70 m <sup>2</sup> ;   |
| GSK-KPA-A-233/11<br>(KPA24694) | Ngastra Nr. 2980, kullotë që ndodhet te vendi i quajtur “Suvi Do” in Dumnicë e Poshtme, Podujevë, me sipërfaqe prej 0 h 09 ar 95 m <sup>2</sup> ;   |
| GSK-KPA-A-234/11<br>(KPA24697) | Ngastra Nr. 2964, kullotë që ndodhet te vendi i quajtur “Suvi Do” in Dumnicë e Poshtme/Donja Dubnica, Podujevë/Podujevo, me sipërfaqe prej 1 h 66 ar 67 m <sup>2</sup> ;  |
| GSK-KPA-A-235/11<br>(KPA24698) | Ngastra Nr. 2979, kullotë që ndodhet te vendi i quajtur “Suvi Do” in Dumnicë e Poshtme, Podujevë, me sipërfaqe prej 0 h 26 ar 29 m <sup>2</sup> ;   |
| GSK-KPA-A-236/11<br>(KPA24700) | Ngastra Nr. 2978, kullotë që ndodhet te vendi i quajtur “Suvi Do” in Dumnicë e Poshtme, Podujevë, me sipërfaqe prej 2 h 38 ar 95 m <sup>2</sup> ; (Lista Poseduese Nr. 382: 0 h 99 ar 28 m <sup>2</sup> );          |
| GSK-KPA-A-237/11<br>(KPA24701) | Ngastra Nr. 2965, tokë ndërtimore, që ndodhet te vendi i quajtur “Suvi Do” in Dumnicë e Poshtme, Podujevë, me sipërfaqe prej 0 h 99 ar 28 m <sup>2</sup> ; (Lista Poseduese Nr. 382: 0 h 77 ar 96 m <sup>2</sup> ); |

Për ta mbështetur kërkesën e saj paraqitësja e kërkesës i dorëzoi AKP-së Vendimin Nr 07-461-18, të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Podujevës më 14 gusht 1993. Me këtë vendim, Komisioni për Kthimin e Tokës ndryshoi Vendimin Nr 07-461-18 të 24 shkurtit 1993 me të cilin këto ngastra i ishin kthyer S. dhe P. P. (dhe pasardhësve tjerë ligjor të V. P.): parcelat kadastrale me numrat 2958, 2962, 2963, 2964, 2965, 2966, 2972/2, 2980, 2981, 2982, 2983, 2984, 3006, 3007, 2979 dhe 2978. Me vendimin e datës 14 gusht 1993 vendimi i shkurtit të vitit 1992 u modifikua në atë mënyrë që në vend të ngastrës Nr. 2979/2 pasardhësve ligjor të V. P. i është dhënë ngastra 1882/3. Në vendimin e

gushtit 1993 Komisioni po ashtu theksoi se vendimi i shkurtit të vitit 1992 ishte bërë përfundimtar më 19 mars 1992.

Me kërkesë të AKP-së, paraqitësi i kërkesës më tej dorëzoi ndër tjera këto dokumente:

- Ankesën kundër vendimit të Komisionit Komunal për Kthimin e Tokës, duke cekur se Kooperativa Përparimi, në emër të së cilës ishin regjistruar ngastrat, është dashur të informohet rreth planeve të Komisionit Komunal dhe është dashur ta miratojë kthimin e pronës;
- Vendimi Nr 461-02-1067/94, lëshuar nga Ministria e Financave të Republikës së Serbisë në Beograd – departamenti për të drejtat pronësore 13 - më 30 tetor 1995 i cili anuloi Vendimin e Komisionit për Kthimin e Tokës të Komunës së Podujevës Nr. 07-461-18, të datës 24 shkurt 1992 dhe 14 gusht 1993;
- Aktgjykimi Nr 7038/95, lëshuar nga Gjykata Supreme në Beograd më 2 prill 1997, i cili (meqë Ministria e Financave nuk kishte dërguar dosjen e lëndëve) anuloi Vendimin Nr 461-02-1067/94 dhe urdhëroi palën përgjegjëse (Ministrinë e Financave) të merr vendim përsëri.

Paraqitësi i kërkesës shpjegoi se familja e saj nuk e kishte përdorur pronën pasi që nuk kishin qenë në gjendje t'i regjistrojnë ndryshimet dhe se për shkak të konfliktit ata nuk kanë qenë në gjendje ta regjistrojnë pronën në emër të tyre. Ajo vet kishte jetuar në Kragujevac që nga viti 1985, i ati i saj ndërkaq, kishte jetuar në Podujevë para konfliktit dhe kishte vdekur në Kragujevac.

AKP u përpoq t'i verifikonte vendimet por nuk pati sukses. Vendimet nuk u gjetën as te Zyra Kadastrale e Podujevës as te Komuna e Podujevës apo në Departamentin e Kadastrit në Niš (Arkivi i Kadastrit të Zhvendosur).

Pas njoftimit të palëve të interesuara lidhur me kërkesën –duke vendosur shenja që tregojnë se prona është objekt i një kërkesë ose me publikim në Gazetën e AKP-së – J. Sh., i cili – sikur pretendohet – si drejtor i kooperativës Përparimi veç kishte qenë i pranishëm në disa njoftime, iu përgjigj kërkesave. Ai shpjegoi se toka e regjistruar në Fletën Poseduese Nr. 382 ishte nën pronësi të Kooperativës Përparimi në Podujevë. Ai paraqiti pranë AKP-së, ndër tjera, Fletën Poseduese Nr. 382, të lëshuar nga Komuna e Podujevës për zonën kadastrale Dumnicë e Poshtme më 9 tetor 2003. Fleta Poseduese Nr. 382 tregon se ngastrat e kërkuara janë në posedim të Kooperativës “Kooperativa Bujqësore Slloga”. Sipas një shënimi në dosjen e AKP-së, Përparimi është një organizatë më e vogël nën organizatën Slloga. Fleta Poseduese Nr. 382 është verifikuar. Në Ekstraktin e Kombeve të

Bashkuara të Fletës Poseduese Nr. 382 të datës 25 tetor 2007 ngastrat me numrat 2964, 2979, 2978 dhe 2965 nuk janë të regjistruara në Çertifikatën e të Drejtave të Paluajtshme Pronësore nga 28 maji 2009, të gjitha ngastrat janë të regjistruara në emër të Kooperativës Bujqësore Slloga.

J. Sh. po ashtu paraqiti pranë AKP-së një përgjigje nga A. R. Sh., të datës 25 shtator 2007. Me këtë dokument A. Sh. iu përgjigj kërkesave të regjistruara nën AKP 24689, KPA24674, KPA24632, KPA24680, KPA24681, KPA24688, KPA24685, KPA24634, KPA24354, KPA24692 dhe KPA24699. Ai deklaroi se një pjesët (4 ha) e ngastrave kontestuese kishte qenë tokë e gjyshit të tij që nga viti 1952 dhe se ai e kishte kultivuar këtë tokë që nga viti 1980. Ai po ashtu theksoi se dokumentet lidhur me këtë tokë ishin djegur në vitin 1999.

Më 23 shkurt 2011, AKP me vendimin e vet KPCC/D/A/102/2011 hodhi poshtë kërkesat pasi që paraqitësi i kërkesës nuk kishte qenë në gjendje të provojë ekzistimin e së drejtës pronësore private mbi pronat në emër të atit të saj.

Vendimi iu dërgua paraqitësit të kërkesës më 14 tetor 2011, dhe J. Sh. e A. Sh. më 6 korrik 2011.

Më 11 nëntor 2011, paraqitësi i kërkesës (më tutje: pala ankuese), paraqiti një ankesë pranë Gjykatës Supreme lidhur me të gjitha lëndët e përmendura. Ajo kundërshtoi vendimin me arsyetimin e shkeljes së ligjit material dhe procedural dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe propozoi që vendimi i kundërshtuar të kthehet mbrapsht.

Ajo deklaroi se e kishte humbur pronën për shkak të konfliktit meqë i ati i saj kishte kërkuar ta regjistronte pronën në emër të tij por për shkak të konfliktit nuk ishte marrë asnjë vendim për këtë kërkesë. Për t'i mbështetur pretendimet e veta, pala ankuese paraqiti një kopje të një dëftese, duke treguar datën si "15.6.1998" dhe numrin e lëndës 08 952-01-1/98-14c. Në të njëjtën faqe është një kopje e vulës drejtkëndore që tregon datën "201", e mbushur me një vulë "11 Nëntor 2011" dhe një vulë të rrumbullakët me një nënshkrim të palexueshëm. Pala ankuese deklaroi se dëftesa është dëftesa e kërkesës së babait të saj për ta regjistruar pronën në emrin e tij dhe se vula drejtkëndore dhe vula e rrumbullakët vërtetojnë dëftesën dhe tregojnë se vendimi (pala ankuese qartazi nënkupton vendimin që pretendohet se i është bashkëngjitur kërkesës) ka qenë përfundimtar dhe i përmbarueshëm. Më tutje pala ankuese deklaroi se dëftesa nuk do të ishte dhënë nëse vendimi, që ishte baza e kërkesës për regjistrimin, nuk ishte vendim përfundimtar. Sipas palës ankuese, edhe libri i regjistrimeve ku duhej të regjistroheshin kërkesat do të tregonte se një vendim i ishte bashkëngjitur kërkesës dhe se ky vendim ka qenë i përmbarueshëm. Pala ankuese fton Gjykatën ta hulumtojë

shënimin në librin e regjistrimeve dhe vendimin e përmbarueshëm në zyrën kadastrale në Podujevë si dhe në kadastrin e zhvendosur. Ajo dhe paraardhësi i saj ligjor nuk duhet të fajësohen për zhvendosjen e kadastrit dhe për konfliktin kështu që ajo nuk duhet t'i bart pasojat e dëmshme.

Ankesa iu dërgua J. Sh. më 13 dhjetor 2011 dhe A. Sh. më 20 prill 2012, asnjëri prej tyre nuk ka reaguar.

Gjykata Supreme i ka bashkuar kërkesat.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa është e pranueshme. Ankesa është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Megjithatë, ankesa është e pabazuar. Kërkesat nuk ka qenë e mundur të pranohen pasi që lëndët nuk janë nën kompetencën e KKPK-së (Neni 11.4 (a) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079). Sidoqoftë, meqë KKPK nuk i ka hedhur poshtë kërkesat për shkak të mungesës së kompetencës, por ka vendosur mbi meritat e lëndëve dhe ka refuzuar kërkesat, ky vendim *ex officio* është anuluar dhe në vend se kërkesat të refuzohen ato janë hedhur poshtë.

Ndonëse KKPK si organ pothuajse-gjyqësor duke vendosur mbi meritat e kërkesës tashmë ka pranuar kompetencën e vet, Gjykata *ex officio* vlerëson nëse lëndët janë nën kompetencën e saj (nenet 194 dhe 182.2 b) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore).

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, një paraqitës kërkesë ka ta drejtë në një urdhër nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm të drejtën në prone por edhe se ai ose ajo tani është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore sipas rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.

Në këtë rast, ndërkaq, paraqitësi i kërkesës nuk ka dëshmuar apo ka dhënë vetëm shenja të mjaftueshme se humbja e pronës ka ndonjë lidhje me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999. E vetmja mënyre me të cilën humbja e pronës mund të jetë shkaktuar nga konflikti i armatosur është se regjistrimi i pronës në emër të atit të saj nuk ka mundur të bëhet për shkak të konfliktit. Gjykata

madje nuk ka nevojë të vendos nëse një situatë si kjo plotëson kushtet e kompetencës së saj. Sidoqoftë, pala ankuese nuk ka dëshmuar që regjistrimi nuk është kryer për shkak të konfliktit të armatosur.

Kontesti rreth pronës ndërmjet të atit të palës ankuese dhe Kooperativës Përparimi fillon që nga viti 1992 kur është lëshuar vendimi i parë i Komisionit për Kthimin e Tokës të Komunës së Podujevës. Paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur prova se kontesti ishte zgjidhur, se ekzistonte një vendim përfundimtar në dobi të atit të saj dhe se vetëm regjistrimi nuk ka mundur të bëhet për shkak të konfliktit të armatosur gjatë 1998/1999 dhe se rrjedhimisht i ati i saj nuk ka mundur ta përdorte pronën për shkak të konfliktit të armatosur.

KKPK me të drejtë ka konkluduar se vendimet e paraqitura nga pala ankuese tregonin vetëm se vendimi i Komisionit për Kthimin e Tokës me të cilin të atit të saj i ishte dhënë pronësia e ngastrave nuk ka qenë përfundimtar.

Madje, AKP është përpjekur ta gjej vendimin përfundimtar në dobi të atit të palës ankuese megjithatë nuk ka mundur ta gjejë. Edhe me ankesën e saj, pala ankuese nuk ka paraqitur një vendim përfundimtar por është kufizuar në deklarin se vendimi përfundimtar duhej të ishte në kadastër. Pretendimet e palës ankuese nuk janë të mjaftueshme për të dëshmuar ekzistimin e dokumenteve, pra vendimin përfundimtar të Komisionit për Kthimin e Tokës, i cili mund të ketë arsyetuar regjistrimin e të drejtës pronësore.

1. Pala ankuese në shkallën e apelit deklaroi për herë të parë se i ati i saj kishte bërë një kërkesë për ta regjistruar pronën e tij të pretenduar më 15 qershor 1998 dhe – po ashtu për herë të parë – paraqiti një kopje të një letre e cila gjoja ka qenë dëftesë e kërkesës dhe cila kishte një numër regjistrimi. Nga kjo, pala ankuese, e cila pohon se kopjet e vulave të cilat po ashtu ajo i ka paraqitur vërtetojnë dëftesën, konkludon se ka ekzistuar një vendim përfundimtar në dobi të atit të saj. Gjykata nuk e pranon këtë konkludim.
  - a. Sa i përket dëftesës, ajo nuk provon asgjë pasi që nuk është – për dallim nga pretendimet e palës ankuese – e vulosur. Kopjet e vulave të cilat sipas palës ankuese duhet të vërtetojnë dëftesën jo vetëm që janë më të mëdha se vet dëftesa (dhe rrjedhimisht nuk përshtateshin me dëftesën), ato po ashtu nuk tregojnë datën 1998, por datën 2011. Gjykata vëren se pretendimet e palës ankuese deri më tani janë

qartazi të rrejshme.

- b. Ndërsa lidhur me ekstraktin e regjistrin i cili sipas mendimit të palës ankuese do të dëshmonte vlefshmërinë e kërkesës dhe se vendimi i paraqitur nga i ati i saj ka qenë përfundimtar: edhe nëse te regjistri do të regjistrohej si i vlefshëm çdo dokument i bashkëngjitur një kërkesë dhe vendimi gjithashtu i regjistruar si i vlefshëm dhe përfundimtar, kjo nuk provon asgjë pasi që ekziston mundësia që referenti të bëjë gabim. Nuk është kompetencë e referentit apo nëpunësit i cili ka pranuar kërkesën të vendos nëse dokumentet e dorëzuara janë të mjaftueshme për ta pranuar kërkesën.
2. Sa i përket kërkesave të palës ankuese që Gjykata apo AKP ta gjurmoj vendimin përfundimtar, Gjykata vërteton se AKM tashmë ka kryer kërkimin dhe nuk ka gjetur një vendim përfundimtar që i jep të drejtën pronësore të atit të palës ankuese. Gjykata nuk është e obliguar ta zhvillojë një kërkim të ri.
    - a. Kjo tashmë rezulton nga fakti se nuk ka arsye pse pala ankuese vet nuk mund t'i merr dokumentet. Nuk ka arsye që ajo vet të mos shkojë apo të dërgojë një përfaqësues dhe t'i kërkojë dokumentet ose nga kadastrin në Podujevë apo nga kadastrin i zhvendosur në Niš. Pala ankuese, megjithatë, edhe pse është informuar nga AKP në disa raste dhe në fund nga vendimi i KKPK-së se ajo duhet ta paraqes vendimin përfundimtar, ajo nuk e bën këtë por kërkon nga Gjykata ta gjej vendimin. Kjo nuk është e mjaftueshme.
    - b. Një arsye e dytë për ta refuzuar domosdoshmërinë e një kërkimi të ri ex officio është se informata e re rreth datës së kërkesës së pretenduar është në kundërtënie me deklaratën e palës ankuese dhënë AKP-së lidhur me datën e kërkesës së atit të saj për regjistrim. Në formularin e kërkesave pala ankuese ka deklaruar se data e humbjes ka qenë 12 qershor 1999. Në një telefonatë me zyrtarin e AKP-së, paraqitësi i kërkesës deklaroi se i ati i saj kishte kërkuar regjistrimin diku në shkurt 1999. Përfundimisht, në ankesën e saj ajo pretendon se kërkesa për regjistrim është e datës 15 qershor 1998 (ajo madje qartazi deklaroi rrejshëm se kopjet e bashkëngjitura të vulave vërtetojnë dëftesën). Megjithatë, informatat kundërtëne nuk e obligojnë Gjykatën ta kryej kërkimin ex officio. Gjykata dëshiron të shtojë më



tutje se dëftesa e pretenduar madje nuk provon se ajo është lëshuar për kërkesën e të atit të palës ankuese.

Rrjedhimisht, pala ankuese nuk ka dëshmuar se ekziston një vendim përfundimtar që do të mund të arsyetonte regjistrimin e të atit të saj në kadastër. Pasi që nuk ka indikacione se pala ankuese ka humbur pronën për shkak të konfliktit të armatosur (dhe jo thjeshtë sepse nuk ka pasur vendim përfundimtar në dobi të atit të palës ankuese), Gjykata konstaton se nuk ka kompetencë në këtë lëndë.

Për këto arsye, ankesa është hedhur poshtë si e pabazë ndërsa vendimi i KKPK-së lidhur me kërkesat është anuluar *ex officio* dhe kërkesat janë hedhur poshtë pasi që nuk ishin nën kompetencën e KKPK-së dhe Gjykatës.

Vendimi i gjykatës është pa paragjykim ndaj të drejtës së palës ankuese që të kërkojë konfirmimin e pronës së saj para organeve kompetente vendore.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhëresës Administrativ (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10,11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10,21, 10,12 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës në fjalë në mënyrë të arsyeshme mund të përlllogaritet të jetë mbi € 100.000: € 500 (€ 50 + 0.5% nga 100.000, por jo më shumë se € 500).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në rastin konkret, shpenzimet gjyqësore duhet të paguhen nga ankuesi në afat prej 90 ditësh nga dita kur aktgjykimi i është dorëzuar atij. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimimi i detyrueshëm i pagesës.

### **Këshillë juridike**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**